

V E N D I M
Nr.441, datë 21.8.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË ÇMIMET E SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
PËRDORUESIT JOFAMILJARË**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.137, datë 31.3.1994 "Për disa ndryshime në çmimet e artikujve energjetikë", në pikën 2, shkronja "b", bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e dytë çmimi i shitjes së energjisë elektrike për disa përdorues të sektorëve kryesorë të ekonomisë dhe për përdoruesit buxhetorë ndryshohet nga 2.1 në 2.4 lekë për çdo kilovat-orë.

2. Në paragrafin e katërt, të gjitha çmimet e energjisë elektrike të caktuara në tabelën e çmimeve të energjisë elektrike për përdoruesit e tjerë jofamiljarë rriten përkatësisht si vijon:

- Çmimet e caktuara në pikën 1 të tabelës rriten në masën 0,3 lekë për çdo kilovat-orë.
- Çmimet e caktuara në pikën 2 të tabelës rriten në masën 0,6 lekë për çdo kilovat-orë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 1 shtator 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi